

KONTRATË SHITJEBLERJE TË AKSIONEVE TË SHOQËRISË

Sot, me date 17.03.2021 (dymijë e njetete e nje), palët e mëposhtme vendosën të lidhin këtë kontratë shitblerje aksionesh si më poshte:

1. **Z. Armand Brahaj**, shtetas Gjerman, i lindur me 06.09.1979, në Rubik, Rreshen, Shqipëri, me banim në Gjermani, identifikuar me Pasaporte me numer personal L8RY7VF24, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar; (Ketu e meposhte referuar si "Shitesi")
DHE
1. **Z. Altin Leksani**, shtetas shqiptar, lindur më 06.05.1971 në Tirane, banues në Tirane – Shqiperi, mbajtes i Kartes se Identitetit nr. H10506051E madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
2. **Z. Denis Behluli**, shtetas shqiptar, lindur me lindur 14.06.1975 në Tirane, banues në Tirane – Shqiperi, mbajtes i Kartes se Identitetit nr. H50614066G madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
3. **Z. Alfons Muçaj**, shtetas hollandez, lindur me 13.08.1980 ne Sinanaj, banues ne Hollande, mbajtes i Pasaportes me NR. NWD48H3C6 madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
4. **Z. Arian Syknej**, shtetas shqiptar, lindur me lindur 02.01.1965 në Tirane, banues në Tirane – Shqiperi, mbajtes i Kartes se Identitetit nr. G50102051V madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
5. **Z. Eno Kotmilo**, shtetas amerikan, lindur me lindur 13.08.1981 në Shqiperi, banues në Shtetet e Bashkuara te Amerikes, mbajtes i Pasaportes nr. 505478330 madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
6. **Z. Igli Gjelishti**, shtetas shqiptar, lindur me lindur 14.07.1984 në Lushnje, banues në Tirane – Shqiperi, mbajtes i Kartes se Identitetit nr. I407104060P madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
7. **Znj. Aljula Hasa**, shtetas shqiptar, lindur me lindur 14.06.1979 në Peshkopi, banues në Tirane – Shqiperi, mbajtes i Kartes se Identitetit nr. H95614008R madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar

(Këtu e mëposhtë referuar vec e vec si **Bleresi ose bashkerisht si Bleresit**)
Shitesi dhe Blerësi do të referohen bashkërisht si "Palët".

Palët bien dakord të nënshkruajnë këtë kontratë shitje të aksioneve të shoqërisë me kushtet e mëposhtme:

DEKLARIME PARAPRAKE

Shitesi zotërojnë aksione në shoqërinë **Rubicon SHA**, me NIPT: M02129014T, (këtu e në vijim referuar si "Shoqëria") sipas përshkrimeve vijuese:

- Z. Armand Brahaj, zotëron 30'695'800 aksione te zakonshme me një vlerë nominale te pergjithshme prej 30'695'800 Lek, e barabartë me 50 (pesëdhjetë)% të kapitalit të shoqërisë te investuar ne natyre dhe ne para;

Per nenshkrimin e kesaj kontrate, Shitesi i ka permbushur te gjitha formalitet e percaktuara ne Statutin e shoqerise dhe Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite tregtare" i ndryshuar.

Neni 1

Objekti i Kontratës

- 1.1 Me anë të kësaj kontrate Shitesi i transferon Blerësve me anë të shitblerjes aksionet si me poshte vijon:

1. Z. Armand Brahaj i shet Z. Altin Leksani 50 aksione te zakonshem me nje vlere nominale te pergjithshme per 50 Lek, e barabarte me 0.0001% të kapitalit të shoqërisë te investuar ne para qe ai zoteron.
 2. Z. Armand Brahaj i shet Z. Denis Behluli 50 aksione te zakonshem me nje vlere nominale te pergjithshme per 50 Lek, e barabarte me 0.0001% të kapitalit të shoqërisë te investuar ne para qe ai zoteron
 3. Z. Armand Brahaj i shet Z. Alfons Muçaj 50 aksione te zakonshem me nje vlere nominale te pergjithshme per 50 Lek, e barabarte me 0.0001% të kapitalit të shoqërisë te investuar ne para qe ai zoteron
 4. Z. Armand Brahaj i shet Z. Arian Syknej 50 aksione te zakonshem me nje vlere nominale te pergjithshme per 50 Lek, e barabarte me 0.0001% të kapitalit të shoqërisë te investuar ne para qe ai zoteron;
 5. Z. Armand Brahaj i shet Z. Eno Kotmilo 50 aksione te zakonshem me nje vlere nominale te pergjithshme per 50 Lek, e barabarte me 0.0001% të kapitalit të shoqërisë te investuar ne para qe ai zoteron;
 6. Z. Armand Brahaj i shet Z. Igli Gjelishti 50 aksione te zakonshem me nje vlere nominale te pergjithshme per 50 Lek, e barabarte me 0.0001% të kapitalit të shoqërisë te investuar ne para qe ai zoteron;
 7. Z. Armand Brahaj i shet Znj. Aljula Hasa 50 aksione te zakonshem me nje vlere nominale te pergjithshme per 50 Lek, e barabarte me 0.0001% të kapitalit të shoqërisë te investuar ne para qe ai zoteron.
- 1.2 Blerësi deklaron se pranon të blejë aksionet e Shoqërisë ne fjale sipas përshkrimit të nenit 1.1 të kësaj kontrate.
- 1.3 Transferimi do të kryhet në përputhje me legjislacionin shqipëtar në fuqi dhe më veçanërisht me dispozitat e Kodit Civil dhe Ligjit Nr. 9901/2008 të ndyshuar, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe Statutin e Shoqërisë.

Neni 2

Çmimi dhe mënyra e pagesës

- 2.1 Transferimi i aksioneve të shoqërisë sipas përshkrimit të nenit 1.1 të kësaj kontrate nga Shitësit tek Blerësi do të kryhet përkundrejt çmimit si më poshtë përshkruar:
1. Z. Altin Leksani do të kryejë pagesën në vlerën prej 50(pesëdhjetë) Lek kundrejt Z. Armand Brahaj
 2. Z. Denis Behluli do të kryejë pagesën në vlerën prej 50(pesëdhjetë) Lek kundrejt Z. Armand Brahaj
 3. Z. Alfons Muçaj do të kryejë pagesën në vlerën prej 50(pesëdhjetë) Lek kundrejt Z. Armand Brahaj
 4. Z. Arian Syknej do të kryejë pagesën në vlerën prej 50(pesëdhjetë) Lek kundrejt Z. Armand Brahaj
 5. Z. Eno Kotmilo do të kryejë pagesën në vlerën prej 50(pesëdhjetë) Lek kundrejt Z. Armand Brahaj
 6. Z. Igli Gjelishti do të kryejë pagesën në vlerën prej 50(pesëdhjetë) Lek kundrejt Z. Armand Brahaj
 7. Znj. Aljula Hasa do të kryejë pagesën në vlerën prej 50(pesëdhjetë) Lek kundrejt Z. Armand Brahaj
- 2.2 Palet deklarojne qe cmimi i transferimit eshte paguar nga Bleresi tek Shitesi me nenshkrimin e kesaj kontrate.

Neni 3

Kalimi i Pronësisë

- 3.1 Me nënshkrimin të kësaj kontrate Aksionet e shoqërisë do të jenë të shpërndara si mëposhte:

- Z. Altin Leksani do te jete zotërues i 50 aksione te zakonshem te shoqerise ne para me vlere nominale 50 Lek e barabarte me 0.0001% te kapitalit te pergjithshem te shoqerise;
 - Z. Denis Behluli do te jete zotërues i 50 aksione te zakonshem te shoqerise me vlere nominale 50 Lek e barabarte me 0.0001% te kapitalit te pergjithshem te shoqerise;
 - Z. Alfons Muçaj do te jete zotërues i 50 aksione te zakonshem te shoqerise me vlere nominale 50 Lek e barabarte me 0.0001% te kapitalit te pergjithshem te shoqerise;
 - Z. Arian Syknej do te jete zotërues i 50 aksione te zakonshem te shoqerise me vlere nominale 50 Lek e barabarte me 0.0001% te kapitalit te pergjithshem te shoqerise;
 - Z. Eno Kotmilo do te jete zotërues i 50 aksione te zakonshem te shoqerise me vlere nominale 50 Lek e barabarte me 0.0001% te kapitalit te pergjithshem te shoqerise;
 - Z. Igli Gjelishti do te jete zotërues i 50 aksione te zakonshem te shoqerise me vlere nominale 50 Lek e barabarte me 0.0001% te kapitalit te pergjithshem te shoqerise;
 - Znj. Aljula Hasa do te jete zotërues i 50 aksione te zakonshem te shoqerise me vlere nominale 50 Lek e barabarte me 0.0001% te kapitalit te pergjithshem te shoqerise;
 - Z. Armand Brahaj do te jete zotërues i 306 954 50 aksioneve te zakonshem te shoqerise me vlere nominale 30 695 450.00 Lek e barabarte me 49.9994% te kapitalit te pergjithshem te shoqerise;
 - Znj. Julia Hoxha do te jete zotëruese e 30 695 800 aksioneve te zakonshem te shoqerise me vlere nominale 30 695 800 Lek e barabarte me 50% te kapitalit te pergjithshem te shoqerise;
- 3.2 Aksionaret do te jene titullar i të drejtave dhe detyrimeve që lidhen me aksionet dhe pjesen taksuese respektive sipas percaktimit ne nenin 3.1, përfshirë pjesmarrjen në fitimet e Shoqërisë, sipas percaktimeve në Statutin e Shoqërisë.

Neni 4

Garancitë dhe detyrimet specifike te Paleve

- 4.1 Shitesi deklaron dhe garanton Bleresin se aksionet e shoqerise objekt të kësaj kontrate, jane te transferueshme dhe e lirë nga çdo barrë, hipotekë apo çdo mjet tjetër për sigurimin e ekzekutimit të detyrimit në përputhje me Legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 4.2 Shitesi deklaron se Shoqeria ka paguar rregullisht dhe në kohë të gjitha taksat, detyrimet, pagesat për kontributet shoqërore dhe çdo kontribut tjetër e tatime të çfarëdo lloji aplikuar brenda Republikës së Shqipërisë në lidhje me të ardhurat, fitimet, aktivet neto, doganat, obligimit të TVSH ose referencat e tjera, në nivel kombëtar apo lokal percaktuar nga legjislacioni në fuqi.
- 4.3 Nese pagesa per kete transaksion nuk kryhet sipas kushteve dhe afateve te percaktuara ne kete Kontrate, seciles pale i lind e drejta te terhiqet nga kjo marrveshje.

Neni 5

Forca Madhore

- 5.1 Asnjëra nga Palët nuk do të konsiderohet përgjegjëse në rast se plotësimi i çfardolloy dispozite vendosur në këtë Kontratë do të vonohet ose do të ndalohet për shkak të forcave madhore ose rastit fator dhe në mënyrë të vecantë për shkaqet si, revolucione, çrregullime, lëvizje popullore, epidemi, luftra, greva, zjarre, përmbytje, tërmete, fenomene të natyrës, shtetëzime, shpronësime, ose akte të pushtetit qëndror apo lokal që kufizojnë lirinë personale apo të sipërmarrjes.

Neni 6

Interpretimi i Kontratës në tërësi

- 6.1 Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së Kontratës dhe brenda qëllimit që i bëri Palët të nënshkruajnë këtë Kontratë.

Neni 7

Legjislacioni i zbatueshem

- 7.1 Për sa i përket çështjeve që kjo Kontratë nuk i rregullon shprehimisht, ato do të rregullohen nga dispozitat e neneve të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë si dhe ligje, dispozita e norma të tjera që janë në fuqi, të cilat drejtëpërdrejtë apo tërthorazi lidhen me objektin e kësaj kontrate.

Neni 8

Zgjidhja e mosmarreveshjeve

- 8.1 Palët bien dakort që çdo mosmarreveshje që mund të lindë nga interpretimi dhe/ose zbatimi i kësaj kontrate do të zgjidhet me mirëkuptim nëpërmjet bisedimeve mes Palëve. Në rast së bisedimet nuk do të japin rezultat, atëherë konflikti do të zgjidhet nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë Shqipëri.

Neni 9

Shpenzimet

- 9.1 Shpenzimet për regjistrimin e kësaj kontrate pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit do të jenë në ngarkim të Blerësit.

Neni 10

Ndryshimet

- 10.1 Çdo ndryshim i përmbajtjes së kësaj Kontrate, duhet të bëhet me shkrim dhe do të firmoset nga Palët.

Neni 11

Hyrja në fuqi

- 11.1 Kjo Kontratë hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga Palët.

Neni 12

Gjuha e kontratës

- 12.1 Kontrata përpilohet në 4 kopje të njëjta në gjuhën Shqipe.

PALËT

SHITËSI

Armand Brahaj

A. H.  

BLERËSI

Altin Leksani




Denis Behluli



Alfons Muçaj



Arian Syknej

Arian Syknej



Eno Kotmilo

Eno Kotmilo


Igli Gjelishti

Igli Gjelishti


Aljula Hasa

Aljula Hasa


A.M